



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

V E N D I M

Nr.961, datë 24.11.2010

PËR

**PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT RREGULLATOR KOORDINUES TË
BAZAVE TË TË DHËNAVE SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 14 të ligjit nr.10 325, datë 23.9.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore", me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti Rregullator Koordinues i Bazave të të Dhënave Shtetërore është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).
2. Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA